

**MINUTAT E TAKIMIT TË GRUPIT TË KONTAKTIT TË TREGUT BANKAR**  
 **MBAJTUR NË SELINË QENDRORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË 19 MAJ 2017**

Në datë 19 maj 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u organizua mbledhja e radhës e Grupit të Kontaktit me pjesëmarrjen e drejtuesve të departamenteve të thesarit të bankave të nivelit të dytë. Takimi u drejtua nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare (DOM) në Bankën e Shqipërisë, z. Marian Gjermani dhe me pjesëmarrje kontribuese me ftesë të DOM të Këshilltarit të FMN-së pranë BSH-së, z. Guido Della Valle, dhe me përfaqësues të tjerë nga DOM, BSh, dhe Ministria e Financave (MoF). Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga 16 banka.

Fjala përshëndetëse u mbajt nga z. Gjermani, i cili prezantoi çështjet për diskutim, me të cilat pjesëmarrësit ishin njohur paraprakisht. Temat kryesore ishin zhvillimi i tregut sekondar të letrave me vlerë dhe efekti në përlllogaritjen e rezervës së detyrueshme i masave të propozuara nga BSH për deeuroizimin. Z. Gjermani njoftoi gjithashtu mbajtjen e konferencës së organizuar nga Banka Botërore në datat 6 dhe 7 qershor, me temë kryesore zhvillimin e tregjeve sekondare.

Tema:	Tregu i letrave me vlerë
Prezantuar:	Z. Guido Della Valle, Këshilltar i FMN-së pranë BSH-së

Z. Della Valle e nisi prezantimin me një përmbledhje të situatës së tregut të letrave me vlerë. Ky treg karakterizohet nga një raport i lartë i borxhit si përqindje e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) (rreth 70%); është kryesisht vendas (mbi 50% nga investitorë vendas), me mungesë të investitorëve të huaj; është i denominuar në monedhën vendase; si dhe është jolikuid e afatshkurtër. Në vijim, z. Della Valle prezantoi shembullin e dy vendeve, Serbisë dhe Armenisë. Serbia ka qenë e suksesshme në diversifikimin e bazës së investuesve, duke rritur përqindjen e investitorëve nga Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga ana tjetër, Armenia përdor sistemin “*Primary Dealers*” dhe ka qenë e suksesshme në promovimin e tregut. Më tej prezantimi vijoi me përfitimet që kanë të gjitha palët e interesuara nga një treg sekondar likuid. Thesari i shtetit përfiton nga rritja e bazës së investitorëve, strukturimi më i mirë i emetimeve të reja dhe ulja e riskut të likuiditetit si rrjedhojë e frekuencës së lartë të sinjaleve të çmimeve. Kërkesa më e lartë ul kështu kostot e emetimit, përfshirë primin e riskut. Një treg sekondar likuid u ofron bankave mundësinë për të menaxhuar më mirë likuiditetin e tyre, dhe për të ulur riskun e likuiditetit, ndërsa investitorëve u ofron mundësinë për diversifikimin e portofolit të tyre dhe minimizimin e kostove të transaksioneve e të riskut të likuiditetit. Banka Qendrore gjithashtu përfiton nga një treg sekondar likuid nëpërmjet menaxhimit më të mirë të portofolit të letrave me vlerë dhe të pozicionit të likuiditetit strukturor. Objektivi final i promovimit të tregut të letrave me vlerë është një treg eficient, likuid dhe elastik, ndërsa objektivi operacional afatshkurtër është pjesëmarrja në ankandet e tregut primar.

Z. Gjermani theksoi rëndësinë e marrjes së opinioneve dhe sinjaleve nga ana e bankave të nivelit të dytë me qëllim zhvillimin e tregjeve të letrave me vlerë. Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë disa hapa në transferimin e një pjese të investimit në letrat me vlerë në tregun sekondar dhe kërkon angazhimin e bankave për të kryer transaksione, në veçanti të letrave të paemtuara akoma në treg. Vihet re që në ankandet e mbajtura bëhen pjesëmarrës një numër i vogël bankash, me gjithë publikimin paraprak të kalendarit të ankandëve. Gatishmëria e bankave tregtare është një kusht thelbësor në zhvillimin e tregut sekondar. Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, po ashtu theksuan që Ministria e Financave është e interesuar të dëgjojë nga përfaqësuesit e bankave rreth nevojave të tyre të cilat mund të plotësohen nga qeveria dhe BSH.

Përfaqësuesit e bankave, nga ana e tyre, u shprehën se u nevojiten nxitje konkrete nga ana e BSH-së, si dhe mundësia për të kryer rolin e ndërmjetësit midis tregjeve primare dhe atyre sekondare. Gjithashtu, u theksua se politikat monetare ndiqen dhe se duhet punuar për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për rritje të kërkesës dhe të likuiditetit në treg. Në lidhje me sistemin “*Primary Dealers*”, pjesëmarrësit u shprehën se implementimi i tij duhet të jetë hapi i parë për të nxitur tregtimin në tregun sekondar, megjithëse impakti i implementimit të sistemit do të vijë pas një transformimi gradual. Në këtë kuadër u propozua lejimi vetëm i bankave të licencuara për të tregtuar, lidhja e përqindjes së pjesëmarrjes me nivelin e portofolit të bankave dhe mundësimi i lehtësirave.

Më pas, në funksion të këtij diskutimi, fjalën e mori z. Keler Gjika, përfaqësues i Bankës Botërore, i cili paraqiti qëllimet e mbajtjes së konferencës së organizuar nga Banka Botërore në datat 6 dhe 7 qershor 2017, si kuptimi i përbashkët ndaj tregut të letrave me vlerë të qeverisë, prezantimi i përvojave të vendeve të tjera dhe diskutimi i hapave, këndvështrimeve dhe pozicioneve të palëve të interesuara. Në këtë kuadër, z. Gjermani theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë konferencë dhe shtrimin e ideve konkrete.

Tema:	Ndryshime në Rezervën e Detyrueshme
Prezantuar:	Z. Klodion Shehu, Drejtor i Departamentit të Stabilitetit Financiar

Pjesa e dytë e takimit u fokusua në ndryshimet që kanë të bëjnë me rezervën e detyrueshme, si pasojë e masave të propozuara nga BSH mbi de-euroizimin. Z. Shehu, Drejtor i Departamentit të Stabilitetit Financiar, paraqiti prezantimin e tij në lidhje me këto ndryshime, duke siguruar se koha e implementimit të këtyre ndryshimeve është e mjaftueshme për të mos pasur ndikim në kursin e këmbimit, dhe se impakti i tyre parashikohet të jetë afatmesëm e afatgjatë.

Në përfundim të takimit, pjesëmarrësit diskutuan mbi çështjen e formalizimit të procedurave të TRIBOR-it duke nënvijëzuar përfitimet afatgjata të funksionimit të tij, si dhe mbi finalizimin e kontratës së unifikuar të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes.